

Dekonstruktimi i Deklaratës së Pavarësisë

Preambula

Të mbledhur në mbledhje të jashtëzakonshme më 17 shkurt 2008, në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë. Duke iu përgjigjur thirrjes së popullit për të ndërtuar një shoqëri që respekton dinjitetin njerëzor dhe afirmon krenarinë dhe synimet e qytetarëve të saj "Duke iu përgjigjur thirrjes së popullit", e jo vullnetit të tyre.

Të zotuar për t'u përballur më trashëgiminë e dhembshme të së kaluarës së afërt në frymë të pajtimit dhe faljes ... "në frymë të pajtimit dhe faljes". Kjo tregon që Kosova qenka e gatshme ta harrojë historinë e saj – humbjet dhe vuajtjet, dhunën dhe gjenocidin e të kaluarës. Kjo deklaratë nuk po paraqitet si kulminim i historisë, por si fillim i saj. Deklarata e zhbën historinë duke e paraqitur veten si fillim të ri. Ky është "veprim historik" pa histori.

Të përkushtuar ndaj mbrojtjes, promovimit dhe respektimit të diversitetit të popullit tonë.

Duke vërejtur se Kosova është një rast special që del nga shpërbërja jokonsensuale e Jugosllavisë dhe nuk është presedan për cilëndo situatë tjetër

Çështja e Kosovës "del nga shpërbërja jokonsensuale e Jugosllavisë". Shpërbërja nuk ishte vetëm "jokonsensuale", por e dhunshme për shkak të Serbisë: Serbia e krijoi Jugosllavinë për t'u zgjeruar vetë, dhe e shkatërroi atë për t'u zgjeruar vetë.

Çështja e statusit të Kosovës nuk "doli" si efekt dytësor nga shpërbërja, por është pjesë e asaj shpërbërjeje. Duke theksuar që Kosova nuk është presedan synohet të thuhet se popujt e shtypur nëpër botë do të duhej të mbeteshin të shtypur edhe pas kësaj deklaratë. Përfshirja e kësaj është rezultat i një mendësie tipike koloniale në emër të burokratëve që e diktuan këtë deklaratë: duke i nxitur popujt e kolonizuar kundër njëri-tjetrit, duke i bërë ata të mos e përkrahin njëri-tjetrin, synohet të parandalohet ngritja e tyre kundër kolonizuesve.

Duke rikujtuar vitet e konfliktit dhe dhunës në Kosovë që shqetësuan ndërgjegjen e të gjithë popujve të civilizuar.

Të thuhet që dhuna në Kosovë "shqetësuar ndërgjegjen e të gjithë popujve të civilizuar" bën që kjo të tingëllojë sikur luftërat këtu më tepër kanë shkakuar ca shqetësim ndaj vështruesve ndërkombëtar duke i shikuar ngjarjet në televizor. Në vend që të theksohet qysh lufta shkeli ligjin ndërkombëtar dhe të drejtat fundamentale njerëzore, sa njerëz humbën jetën, sa u plagosën, u dhunuan e dëbuan, deklaratat thjesht i referohet vetëm dhimbjes shpirtërore që ajo ua shkaktoi "popujve të civilizuar". Është turp që në një deklaratë për "pavarësi" të gjendet shprehja raciste "popujt e civilizuar", duke lënë të nënkuptohet se paska edhe "popujt të pacivilizuar". Kjo shprehje po ashtu nënkupton që serbët nuk duhet fajësuar për dhunën që ndodhi.

Të flitet për dhunën në Kosovë në mënyrë kaq të paanshme e amnistion Serbinë nga çfarëdo faji.

Mirënjohës që bota intervenoi më 1999 duke hequr në këtë mënyrë qeverisjen e Beogradit mbi Kosovën, dhe vendosur Kosovën nën administrimin e përkohshëm të Kombeve të Bashkuara.

Është e pasaktë të thuhet që "bota" ndërhyri. Rusia ishte kundër ndërhyrjes dhe nuk mori pjesë në të. Të thuhet që ndërhyrja "hoqi qeverisjen e Beogradit" dhe e vendosi Kosovën nën administrimin e OKB-së bën që e tëra të tingëllojë sikur krejt ngjarja nuk ishte asgjë më shumë sesa ndryshim administrativ. Për më tepër, nuk qe vetëm qeverisja e Beogradit ajo që u hoq me këtë ndërhyrje, por dhuna e forcave policore dhe ushtarake kriminale të Serbisë. Meqë nuk po thuhet që Beogradi nuk ka më "kontroll" apo "të drejtë mbi" Kosovën, e gjithë kjo pikë po na thotë që thjesht Beogradi vetëm nuk po i qeveris më punët e përditshme të Kosovës.

Krenarë që Kosova që atëherë ka zhvilluar institucione funksionale, multietnike të demokracisë që shprehin lirisht vullnetin e qytetarëve tanë "institucionet e demokracisë" sërish në asnjë mënyrë nuk tregon që kemi të bëjmë me shtetin e pavarur sovran. Kjo pikë po ashtu e redukton vullnetin e popullit të Kosovës në disa institucione vendore josovrane dhe të

korruptuara. Për herë të parë kur përdoret një fjalë e përafërt me “lirinë” – “lirisht” më shumë ka të bëjë me të drejtën e shprehjes të institucioneve të Kosovës, të drejtat dhe liritë për të marrur veprime si shtet i pavarur.

Duke rikujtuar vitet e negociatave të sponsorizuara ndërkombëtarisht ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës mbi çështjen e statusit tonë të ardhshëm politik “statusi ynë i ardhshëm” e bën të qartë që statusi ynë nuk është përfundimtar dhe se po shkojmë prej tranzicioni në tranzicion.

Duke shprehur keqardhje që nuk u arrit asnjë rezultat i pranueshëm për të dyja palët përkundër angazhimit të mirëfilltë të udhëheqësve tanë Duke thënë që asnjë zgjidhje e negociuar nuk ishte e mundur nuk është gjë tjetër veçse shmangie e fajësimi për obstruksionizmin e Serbisë për dështimin e bisedimeve.

Duke konfirmuar se rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, i ofrojnë Kosovës një kornizë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e saj të ardhshëm, dhe janë në vijë me standardet më të larta evropiane për të drejtat të njeriut dhe qeverisjen e mire Ahtisaari nuk ka sjellur kornizë për zhvillim, por në të vërtetë do ta bllokojë zhvillimin, dhe bile na zhvesh nga mundësia e zhvillimit duke e përjetësuar paradigmën e stabilitetit përbrenda të cilës vepron bashkësia ndërkombëtare në Kosovë. Plani gjithashtu do ta ndajë popullin institucionalisht dhe territorialisht mbi bazë etnike. Plani i Ahtisaarit nuk ka të bëjë asgjë me të “drejtat e njeriut”, por kërkon decentralizim të fuqishëm të mbështetur etnikisht përpara sovranitetit, pa i shpërbërë paraprakisht strukturat e Serbisë brenda në Kosovë. Kjo nuk do t’i mbrojë të drejtat e njeriut, por do të çojë në shkelje të reja.

Po ashtu, po qe se Plani i Ahtisaarit paraqet “standardet më të larta evropiane” për “qeverisje të mirë”, si bëhet që asnjë vend tjetër evropian nuk e ka zbatuar atë?

Të vendosur që ta shohim statusin tonë të zgjidhur në mënyrë që t’i jipet popullit tonë qartësi mbi të ardhmen e vet, të shkohet përtej konflikteve të së kaluarës dhe të realizohet potenciali i plotë demokratik i shoqërisë sonë Kosovës nuk i mungon statusi, por popullit të saj i mungon liria. Kjo deklaratë nuk do të na e sjell lirinë. Në të vërtetë, ajo nuk përfaqëson ndërrim statusi, meqë do të vazhdojmë të jemi të qeverisur nga një mision antidemokratik jollogaridhënës ndërkombëtar. Sa për “qartësinë” – kjo deklaratë nuk sjell qartësi por një numër kontradiktash dhe dykuptimisish serioze. Bile qartësia nuk është çështja: ne duam liri dhe dinjitet. Në mënyrë që kjo të arrihet, populli duhet të vendos për ndryshimin e statusit të Kosovës nëpërmjet referendumit për pavarësi. Thirrja që “të shkohet përtej konflikteve të së kaluarës” përsëri është thirrje për fshirjen e historisë. Është e pamundur të flitet për “potencial të plotë demokratik” duke qenë i privuar nga demokracia nga njerëzit që qeverisin mbi ne.

Duke nderuar të gjithë burrat dhe gratë që bënë sakrifica të mëdha për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për Kosovën Kjo pika e fundit është aq e paqartë sa që mund t’iu referohet edhe disa njerëzve të lënduar gjatë punëve në kantier. Sërisht, formulimet e paqarta janë zgjedhur për ta fshirë të kaluarën dhe për të mos e fajësuar Serbinë për tragjeditë tona historike.

Pikat e numëruara:

1. Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

Kjo pikë është seriozisht kundërtënëse. Të qenit shtet i pavarur sovran është tërësisht i papajtueshëm me planin e Ahtisaarit dhe rekomandimet e tij. Ai nuk sugjeron sovranitet, por pavarësi skajshmërisht të mbikëqyrur. Ose Kryeministri nuk e di ç'është "sovraniteti", ose do të na mashtrojë. Të ashtuquajturit udhëheqësit e zgjedhur në mënyrë demokratike, nuk janë as udhëheqës, as demokratik. Më pak se 50% e popullit ka votuar për ta përbrenda një kornize të imponuar nga jashtë dhe proceseve prej së larti që nuk kanë të bëjnë asgjë me demokraci. Kjo deklaratë nuk mund të pasqyrojë "vullnetin e popullit tonë" sa kohë që na mohohet e drejta e mbajtjes së referendumit.

2. Ne shpallim Kosovën një republikë demokratike, laike dhe multietnike, të udhëhequr nga parimet e jodiskriminimit dhe mbrojtjes së barabartë sipas ligjit. Ne do të mbrojmë dhe promovojmë të drejtat e të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe krijojmë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse.

Kjo deklaratë nuk do të sjell mbrojtjen e barabartë të njerëzve para ligjit, por do ta themelojë një zyre ndërkombëtare që do të qeveris mbi ne nëpërmjet zyrtarëve plotësisht jollogaridhënës dhe imun ndaj ligjeve që na i zbatojnë neve. Kjo pikë flet për "komunitete", jo për qytetarë, dhe konfirmon fiksimin etnik të bashkësisë ndërkombëtare ndaj Kosovës.

3. Ne pranojmë plotësisht obligimet për Kosovën të përmbajtura në Planin e Ahtisaarit, dhe mirëpresim kornizën që ai propozon për të udhëhequr Kosovën në vitet në vijim. Ne do të zbatojmë plotësisht ato obligime, përfshirë miratimin prioritar të legjisllacionit të përfshirë në Aneksin XII të tij, veçanërisht atë që mbron dhe promovon të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Sërish përmenden "komunitetet" në vend se qytetarët, dhe obligimet në vend se të drejtat.

4. Ne do të miratojmë sa më shpejt që të jetë e mundur një kushtetutë që mishëron zotimin tonë për të respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve tanë, posaçërisht ashtu siç definohej me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kushtetuta do të inkorporojë të gjitha parimet relevante të Planit të Ahtisaarit dhe do të miratohet nëpërmjet një procesi demokratik dhe të kujdesshëm.

Plani i Ahtisaarit nuk është në pajtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në të vërtetë, aty në plan nuk ka qenie njerëzore, por vetëm komunitete, të cilat do të ndahen e përçahen edhe më shumë nga ky plan.

5. Ne mirëpresim mbështetjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare për zhvillimin tonë demokratik nëpërmjet të pranive ndërkombëtare të themeluara në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999). Ne ftojmë dhe mirëpresim një prani ndërkombëtare civile për të mbikëqyrur zbatimin e Planit të Ahtisaarit dhe një mision të sundimit të ligjit të udhëhequr nga Bashkimi Evropian. Ne, po ashtu, ftojmë dhe mirëpresim NATO-n që të mbajë rolin udhëheqës në praninë ndërkombëtare ushtarake dhe të zbatojë përgjegjësitë që i janë dhënë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999) dhe Planit të Ahtisaarit, deri në atë kohë kur institucionet e Kosovës do të jenë në gjendje të marrin këto përgjegjësi. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me këto prani në Kosovë për të siguruar paqen, prosperitetin dhe stabilitetin në të ardhmen në Kosovë.

Kjo pikë faktikisht thotë që Kosova nuk don të bëhet e pavarur. Ajo e zbraz madje edhe vetë pavarësinë formale nga çfarëdo kuptimi e substance. Pranitë ndërkombëtare bazuar në Rezolutën 1244 nuk janë demokratike dhe nuk e promovojnë demokracinë. Përkundrazi, ato janë autoritare dhe ekzekutive. Duke kërkuar nga NATO që të qëndrojë këtu deri sa Kosova “të jetë në gjendje” të marrë “përgjegjësi” ushtarake është zhvlerësim i vetes. Duke bërë fjalë për “paqen, prosperitetin dhe stabilitetin” po zbulohet fokusi i bashkësisë ndërkombëtare për stabilitet dhe paqe e jo për liri e progres.

6. Për arsye të kulturës, gjeografisë dhe historisë, ne besojmë se e ardhmja jonë është në familjen evropiane. Për këtë arsye, ne shpallim synimin tonë për të marrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar anëtarësim të plotë në Bashkimin Europian sapo që të jetë e mundshme dhe për të zbatuar reformat e kërkuara për integrim evropian dhe euroatlantik.

Nuk është e nevojshme dhënia e “arsyeve” pse Kosova është evropiane. Ne jemi të tillë. Kjo pikë nuk thotë që Kosova ka për qëllim të bëhet anëtare e BE-së si shtet sovran, por vetëm tregon që “e ardhmja jonë është në familjen evropiane”.

7. Ne i shprehim mirënjohje Organizatës së Kombeve të Bashkuara për punën që ka bërë për të na ndihmuar në rimëkëmbjen dhe rindërtimin pas lufte dhe ndërtimin e institucioneve të demokracisë. Ne jemi të përkushtuar të punojmë në mënyrë konstruktive me Organizatën e Kombeve të Bashkuara gjersa ajo vazhdon punën e saj në periudhën në vijim.

UNMIK-u nuk ka ndihmuar zhvillimin tonë demokratik. UNMIK-u është antidemokratik dhe dështim madje edhe sipas vetë pikëpamjeve të zyrtarëve të tij dhe sipas qëllimeve të vetëshpallura. Kjo pikë thotë gjithashtu që UNMIK-u do të vazhdojë të qëndrojë këtu përgjithmonë. Prandaj Kosova e “pavarur” do të qeveriset prej dy misioneve ndërkombëtare, jo vetëm nga një !

8. Me pavarësinë vie detyra e anëtarësisë së përgjegjshme në bashkësinë ndërkombëtare. Ne e pranojmë plotësisht këtë detyrë dhe do t’i përmbahemi parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Aktin Final të Helsinkit, akteve tjera të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë, obligimeve ligjore ndërkombëtare dhe parimeve të marrëdhënieve të mira ndërkombëtare që shënojnë marrëdhëniet ndërmjet shteteve. Kosova do të ketë kufijtë e saj ndërkombëtarë ashtu siç janë paraparë në Aneksin VIII të Planit të Ahtisaarit, dhe do të respektojë plotësisht sovranitetin dhe integritetin territorial të të gjithë fqinjve tanë. Kosova, po ashtu, do të përmbahet nga kërcënimi apo përdorimi i forcës në cilëndo mënyrë që është jokonsistente me qëllimet e Kombeve të Bashkuara.

Kjo pikë flet për detyrën e anëtarësimit të përgjegjshëm në organizatat ndërkombëtare, por jo për të drejtat dhe marrëdhëniet ndërkombëtarisht të barabarta. Kjo për shkak se të drejtat e Kosovës do të vazhdojnë të jenë në duart e administrimit ndërkombëtar këtu. Ahtisaari nuk thotë asgjë lidhur me kufijtë “ndërkombëtar” në aneksin VIII, por përmend në Nenin 3 që Kosova duhet ta mbështes marrëveshjen për kufirin nënshkruar ndërmjet Jugosllavisë (Serbisë) dhe Maqedonisë në shkurt të vitit 2001 në të cilën Maqedonia i mori 2.500 hektarë të tokës së Kosovës.

9. Ne, nëpërmjet kësaj Deklarate, marrim obligimet ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë ato të arritura në emrin tonë nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), si dhe obligimet e traktateve dhe obligimet tjera të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ndaj të cilave obligohemi si ish-pjesë konstituive, përfshirë konventat e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Ne synojmë të kërkojmë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, në të cilat Kosova do të synojë të kontribuojë për qëllime të paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar.

Përderisa pika e mëparshme flet për detyra, kjo pikë përmend obligimet e Kosovës dhe kontributet për të cilat na zoton kjo deklaratë. Të drejtat dhe liritë tona ende nuk përmenden. Sërisht fjalë për paqen dhe sigurinë, por jo për zhvillim, përparim, mirëqenie.

10. Kosova shpall zotimin e saj ndaj paqes dhe stabilitetit në rajonin tonë të Europës Juglindore. Pavarësia jonë e sjell në fund procesin e shpërbërjes së dhunshme të Jugosllavisë. Gjersa ky proces ka qenë i dhembshëm, ne do të punojmë pa pushim për t'i kontribuar një pajtimi që do të lejonte Europën Juglindore të shkojë përtej konflikteve të së kaluarës dhe të farkojë lidhje të reja rajonale të bashkëpunimit. Për këtë arsye, do të punojmë së bashku me fqinjët tanë për të avansuar të ardhmen tonë të përbashkët europiane.

Çintegrimi o Jugosllavisë nuk përfundon domosdoshmërisht me pavarësinë e Kosovës. Duke thënë që ajo përfundon me Kosovën, deklarata synon t'i zhvlerësojë përpjekjet e hungarezëve në Vojvodinë, shqiptarëve në Luginë të Preshevës dhe boshnjakëve në Sanxhak për të dalur nga sundimi serb. Dhe sërisht kjo pikë thekson pajtimin në mënyrë që të harrohet e kaluara.

11. Ne shprehim, në veçanti, dëshirën tonë për të vendosur marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët tanë, përfshirë Republikën e Serbisë, me të cilën kemi marrëdhënie historike, tregtare dhe shoqërore, të cilat synojmë t'i zhvillojmë më tej në të ardhmen e afërt. Ne do të vazhdojmë përpjekjet tona për t'i kontribuar marrëdhënies së fqinjësisë dhe bashkëpunimit me Republikën e Serbisë duke promovuar pajtimin ndërmjet popujve tanë.

Kjo pikë është një përpjekje për përshkrim të paanshëm të marrëdhënies sonë me Serbinë, kur secili prej nesh e di që kjo marrëdhënie në të vërtetë nënkuptonte: shfrytëzimin, shtypjen dhe sundimin nga Serbia.

12. Ne, nëpërmjet kësaj, afirmojmë në mënyrë të qartë, specifike dhe të përvokueshme se Kosova do të jetë ligjërisht e obliguar të plotësojë dispozitatat e përmbajtura në këtë Deklaratë, përfshirë këtu veçanërisht obligimet e saj nga Plani i Ahtisaarit. Në të gjitha këto çështje, ne do të veprojmë në pajtueshmëri në parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Rezolutën 1244 (1999). Ne shpallim publikisht se të gjitha shtetet kanë të drejtën të mbështeten në këtë Deklaratë, dhe i bëjmë apel të na ofrojnë përkrahjen dhe mbështetjen e tyre.

Kjo pikë e rëndësishme, që këtu paraqitet e fundit, nuk e përmend pavarësinë, por Planin e Ahtisaarit dhe Rezolutën 1244.

Kjo pikë nuk parashtron kërkesë eksplicite për njohje duke sinjalizuar që ne do ta kuptojmë dikë i cili do të vendosë të mos na njohë.